

STATUTI
I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"DIVA SOC-AGR-SRL" SH.P.K..

Sot ,me 12/04/2021 , ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republikën e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private Siper marrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marrëdhëniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e saj te lire ,te nenshkruar ne kete Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

Lek Prendi lindur ne Shkoze me 03/06/1984 ne Shqiperi, me numer dokumenti I40603069V, I cili ka vendosur te hartohet Statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

Neni 1 – Emertimi

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **DIVA SOC-AGR-SRL Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

Neni 2 – Forma ligjore

2.1 Shoqeria **DIVA SOC-AGR-SRL Sh.p.k.** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlere ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi

2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Neni 3 – Selia

3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Tirane,Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pallati 68,Hyrja 10,Apartamenti 15.

3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.

3.3 Mbledhja e Ortakeve, mund të vendose, transferoje dhe/ose të mbylle, si brenda edhe jashtë shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale, seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të cdo natyre.

Neni 4 – Objekti

Shoqëria ka për objekt social cdo operacion tregtar legjitim i cili përfshin por nuk kufizohet në aktivitetet e listuara si më poshtë:

I. ushtrimin e të gjitha aktiviteteve që synojnë kultivimin e tokës, pylltarinë, mbarështimin e bagëtive, çdo aktivitet tjetër të lidhur me prodhimin, përpunimin, trajtimin, konservimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe cdo aktivitet tjetër të lidhur dhe të ngjashëm me bujqësinë; marrja me qira dhe dhënia me qira e pasurive bujqësore, ndërtesave dhe pronave të tjera për përdorim bujqësor; permiresim i punimeve ekzistuese, rikuperimi dhe ristrukturimi i tokës dhe ndërtesave, makinave dhe impianteve për përdorim bujqësor; blerjen ose marrjen me qira të pronave bujqësore; ushtrimi i aktiviteteve në agroturizem, në përgjithësi administrimi i hoteleve dhe aktiviteteve të kohës së lire.

II. tregtia me shumicë dhe pakicë e frutave dhe perimeve dhe produkteve ushqimore në përgjithësi dhe krijimi i bashkëpunimeve me agjensite, agjentët komisioner dhe përfaqësuesve për shpërndarjen e produkteve të lartpërmendura dhe menaxhimin e ndërtesave dhe faciliteteve të nevojshme;

III. tregtia e mjeteve teknike për sektorët agro-pyjor, agroushqimor dhe agro-mjedisor (p.sh. testimi i produkteve fitosanitare; vlerësimi i agrokimikëve dhe mjeteve biologjike; vlerësimi i plehrave; zhvillimi teknik dhe tregtar);

V. prodhimin dhe tregtimin e produkteve tipike ushqimore;

V. përpunimi, prodhimi, paketimi, shitja dhe shpërndarja e produkteve ushqimore në përgjithësi;

VI. tregtia me pakice e lendeve ushqyese dhe prodhimin e lendeve të para ushqimore për t'u shitur me pakice

VII. tregtia me pakice dhe shumice e lendeve ushqimore dhe pijeve në përgjithësi, dhe alkolike, lendet ushqimore të gastronomisë, rosticerisë, mishit, pasticërisë, ushqimet e ngrira, frutave, perimeve, produktet ushqimore të konservuara, vajra, vezët, si dhe produkte jo ushqimore.

VIII. tregtia me shumice ose pakice e kripës, djathrave, verërave dhe cdo produkti tjetër ushqimor

IX. shitje me korrespondence të produkteve ushqimore, mishit, sallameve dhe djathrave;

X. tregtia me pakicë dhe shumicë e bimëve dhe luleve, farave, plehrave, vazove, artikujve dhe pajisjeve të kopshtarisë, artikujve dhe pajisjeve për bujqësi dhe blegtori; shoqëria mund të organizojë kurse trajnimi në sektorët e sipërpërmendur për trajnimin e personave dhe, përveç kësaj, kurse të destinuara për të huajt dhe njerëzit me aftësi të kufizuara, gjithçka në përputhje me ligjin. Sipas objektit social, shoqëria mund të menaxhojë mensa dhe restorante duke përfshirë furnizimin e ushqimit dhe pijeve për publikun dhe furnizimin me ushqime të gatuar dhe paketuara. Për atë që është e nevojshme, shërbimet e lartpërmendura do të u besohen profesionistëve të regjistruar në regjistrat profesionale. Kjo do të përmbushet nepermjet çdo operacioni tregtar, në përputhje me objektin social, përfshirë bashkimin dhe lidhjen dhe me shoqëri të tjera që kryejnë veprimtari të ngjashme apo plotësuese.

XI. Pjesëmarrja në shoqëri kombëtare dhe të huaja, shoqëri apo korporata, të themeluara apo që janë në proces themelimi, industriale dhe tregtare, punësimin dhe bashkëpunimin me agjensitë e perfaqësimit dhe me pak fjalë për të vendosur një marrëdhënie tjetër juridike ose formë kontraktuale të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Shoqëria do të jetë në gjendje të sigurojë garanci dhe perkrahje, dhe garanci reale për paletë të treta.

XII. aktivitete trajnimi dhe shërbimi për individët lokalë dhe entet lokale në lidhje me ofrimin e shërbimeve;

XIII. Aktivitetet e publikimit për të mbështetur arritjen e objektivave të mësipërme;

XIV. Shoqëria do të kryejë aktivitete kërkimore, trajnuese, planifikimi, konsulence dhe informatike;

XV. Përfaqësimi dhe ndërmjetësimi i biznesit në vend dhe jashtë saj për çdo të mirë (lëndë të parë, produkte gjysëm të gatshme, produkte të gatshme) dhe shërbime;

XVI. Marketingu në vend dhe jashtë saj për çdo mall (p.sh. lëndë e parë, produkte gjysëm të gatshme, produkte të gatshme, patenta) në pakicë, me shumicë etj ... duke përdorur çdo kanal shpërndarjeje, përfshirë këtu kanalet online dhe tregtinë elektronike. Kompania gjithashtu mund të kryejë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me qëllimin e saj institucional, në veçanti, marrjen me qira të pasurive të luajtshme ose paluajtshme, organizimin e ngjarjeve kulturore për promovimin dhe forcimin e territorit, takime, kongrese, workshope në

Shqipëri dhe jashtë saj, planifikimi , realizimin dhe asistencen e faqeve në internet, hulumtimin dhe zhvillimin;

XVII. Shoqëria, për të arritur objektivat e saj, mundet në përputhje të plote me legjislacionin në fuqi, të kryejë çdo veprimtari të lidhur direkt me ato të parashikuara si objekt në nenin prezent dhe në vecanti të kryejë tregti të pronave të luajtshme, të paluajtshme, industriale dhe financiare, të krijojë marrëdhënie bashkpunimi, të ketë pjesëmarrje në shoqëri të tjera, shqiptare dhe të huaja, të bashkëpunojë me institucione të tjera private dhe publike, civile ose fetare, qëllimet e të cilave janë të njëjta ose të ngjashme me këto shoqëri:

XVIII. Menaxhimi i pasurive të paluajtshme në pronësi të saj apo të palëve të treta;

XIX. Qiraja (me përjashtim të leasing-ut aktiv) të ndërtesave në pronësi;

XX. Tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe import-eksporti i automjeteve, makinave, makinerive për industrinë;

XXI. Shoqëria mund të kontrakttojë kredi dhe në përgjithësi të përdorë çdo lloj formë financimi me institucionet e kreditit, me bankat, me kompani ose individë privatë, duke përdorur dhënien e letrave me vlerë të vlefshme dhe garanci të pasurive të paluajtshme reale dhe personale.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

Neni 6 – Kapitali

6.1. Kapitali është 10.000 (dhjetë mijë) leke i përbërë nga 1 (një) kuotë e barazvlefshme me vlerë nominale përkatësisht 10 000 (dhjetë mijë) leke të **Lek Prendi**, -t

6.2 Kapitali i shoqërisë është plotësisht i regjistruar dhe i leshuar në mënyrë të meposhtme:

Lek Prendi, zoteron 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë i barazvlefshëm me 1 (një) kuotë.

Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

Neni 8 – Administratorët

8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të vepronjë veçmas ose bashkërisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.

- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u riemëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.
- 8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure te veçantë për një akt ose një sërë aktesh.
- 8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas nje tarife te parashikuar ne ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.

8.7 Me kete akt themelimi vendoset si Administrator i Shoqerise:

LEK PRENDI lindur ne SHKOZE ,SHQIPERI me 03/06/1984 dhe numer dokumenti I40603069V.

Artikull 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.
- 9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrueshmë ligjor.
- 9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm te Shoqërisë **DIVA SOC-AGR-SRL Sh.p.k** i cili nenshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

* * *

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

LEK PRENDI

Leke Prendi
